



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 20 qershor 2011
Nr. ref.: RK 118 /11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 128/10

Parashtruesi

Arben Komani

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Drejtorisë së Arsimit të Kuvendit
Komunal të Gjakovës Nr. 4, i datës 29 janar 2010**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Arben Komani, babai i të miturit David Komani, nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Vendimin e Drejtorisë së Arsimit të Kuvendit Komunal të Gjakovës Nr. 4, të 29 janarit 2010, i cili i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 6 shkurt 2010.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës pohon se Gjykata Supreme dhe organet administrative duke heshtur dhe duke mos trajtuar çështjen me prioritet, kanë shkelur:
 - a. Nenin 3 të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve në lidhje me nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: në tekstin e mëtejme: Kushtetuta);
 - b. Nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës;
 - c. Nenet 2 dhe 7 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut në lidhje me nenin 22 të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009 (Nr. 03/L-121) (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e Punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 16 dhjetor 2010, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 27 janar 2011, kërkesa u përcoll në Gjykatën Supreme dhe në Drejtorinë e Arsimit në Kuvendin Komunal të Gjakovës.
7. Më 14 shkurt 2011, Presidenti, me Urdhrin Nr. GJR. 128/10, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalovič si Gjyqtar raportues. Po të njëjtën ditë, Presidenti, me Urdhrin Nr. KSH. 128/10, caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Gjyljeta Mushkolaj.
8. Më 18 maj 2011, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 26 dhjetor 2009, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë tek Inspektori kryesor i arsimit në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (në tekstin e mëtejme:

MASHT) kundër mësuesit të djalit të tij, duke u ankuar se mësuesi i kishte shkaktuar stres dhe lëndime djalit të tij në shkollë.

10. Më 12 janar 2010, Departamenti i Inspektimit të MASHT-it në Gjakovë kreu një inspektim në shkollë.
11. Më 13 janar 2010, parashtruesi i kërkesës edhe njëherë dorëzoi ankesën tek Inspektori kryesor i arsimit në MASHT, duke deklaruar se mësuesi i djalit të tij mori ankesën e parë më 26 dhjetor 2009 dhe për pasojë, djalit të tij kjo i kushtoi me vuajtje nga ankthi dhe ndjenjat e pasigurisë.
12. Më 19 janar 2010, kabineti i Sekretarit të Përhershëm të MASHT-it lëshoi një rekomandim për të themeluar një komision për shqyrtimin e ankesës dhe marrjen e masave të duhura kundër mësuesit, si dhe raportimin për veprimet e ndërmarra në Sektorin e inspektorëve në Gjakovë.
13. Më 29 janar 2010, Komisioni disiplinor i themeluar nga Drejtorati për arsim në Gjakovë, lëshoi vendimin (Nr.04). Parashtruesi i kërkesës ishte udhëzuar të sjellë ankesën e tij para bordit të shkollës, ku punonte mësuesi, si dhe u kërkua nga drejtori i shkollës të shqyrtonte ankesën e parashtruesit dhe të merrnin vendim në bazë të meritave të ankesës. Parashtruesit të ankesës i ishte thënë se po qese nuk do të jetë i kënaqur me rezultatin, ai mund të paraqiste rastin para Inspektorit kryesor të arsimit në MASHT. Për më tepër, vendimi mund të kontestohet para Komisionit të ankesave.
14. Më 8 shkurt 2010, parashtruesi i kërkesës u ankua në Departamentin Komunal të Arsimit kundër vendimit të Komisionit disiplinor, të 19 janarit 2010.
15. Më 27 mars 2010, Komisioni disiplinor gjeti se mësuesi kishte vepruar në mënyrë jo profesionale dhe i kishte dhënë asaj vërejtje me shkrim. Parashtruesi i kërkesës kishte të drejtë ankese rreth vendimit në Departamentin Komunal të Arsimit, gjë që siç duket ai nuk e bëri kurrë.
16. Më 8 Prill 2010, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesën në Gjykatën Supreme duke u ankuar rreth heshtjes administrative dhe shkeljes së dispozitave ligjore.
17. Më 16 shtator 2010, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesën në Gjykatën Supreme për vendim urgjent në lidhje me rastin.

Pretendimet e parashtruesit

18. Parashtruesi i kërkesës pohon se është shkelur neni 3 i Konventës mbi të Drejtat e Fëmijëve në lidhje me nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] i Kushtetutës, neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës dhe nenet 2 dhe 7 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut në lidhje me nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe

Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës duke heshtur dhe duke mos kualifikuar çështjen si prioritare.

19. Sipas parashtruesit të kërkesës, në të gjitha procedurat para organeve administrative ai kishte hasur në heshtje administrative, shkelje të dispozitave ligjore dhe delegimin e padrejtë të kompetencave vetëm sa për t'u shty rasti dhe sa për t'u ikur përgjegjësive në fjalë, përderisa autoritetet kompetente refuzojnë të ndërmarrin masa ndëshkuese kundër shkelësve të ligjit dhe shkaktojnë vonesa të panevojshme të procedurave në përgjithësi, duke mos marrë një vendim përfundimtar dhe duke i anashkaluar interesat e prindërve, dhe po ashtu duke tentuar të pengojnë procesin, në dëm të djalit të tij, duke mos u përgjigjur në ankesa.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se është shkelur neni 3 i Konventës mbi të Drejtat e Fëmijëve në lidhje me nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës, neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës dhe nenet 2 dhe 7 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut në lidhje me nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës duke heshtur dhe mos kualifikuar çështjen si prioritare.
21. Sa i përket pohimeve të parashtruesit të kërkesës se Gjykata Supreme dhe organet administrative kanë qenë të ngadalshme ndaj rastit të tij, Gjykata i referohet praktikës së mëparshme relevante të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ku thuhet se “arsyeshmëria e zgjatjes së procedurave duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të rastit dhe duke pasur parasysh kriteret në vijim: kompleksitetin e rastit, sjelljen e parashtruesit të kërkesës dhe autoriteteve relevante, si dhe çfarë ishte në pyetje për parashtruesin në këtë mosmarrëveshje” (shih, mes shumë autoritetesh tjera, Frydlander kundër Francës [GC], nr. 30979/96, § 43, GJEDNj2000-VII).
22. Sidoqoftë, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, është e nevojshme që së pari të analizohet nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri të parapara me Kushtetutë, si dhe të cekura në Ligjin dhe Rregulloren e punës, në veçanti, nëse i ka shterur të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj.
23. Arsyetimi për rregullin e shterjes së mjeteve bëhet në mënyrë që t'u mundësohet autoriteteve përkatëse, përfshirë edhe gjykatat, mundësia e parandalimit apo rregullimit të shkeljeve të pretenduara të Kushtetutës. Rregulli është i bazuar në supozimin se rendi ligjor në Kosovë do të ofrojë përmirësim efektiv të shkeljeve të të drejtave kushtetuese (shih, Aktvendimi mbi papranueshmërinë: Universiteti AAB-RIINVEST i Prishtinës kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, i datës 27 janar 2010 dhe mutatis mutandis, GJEDNj, Selmouni kundër Francës, Nr. 25803/94, Aktgjykimi i 28 korrikut 1999).

24. Në këtë rast, Gjykata vëren se sa i përket pohimit të parashtruesit të kërkesës, të cilin ai po e bën në këtë Gjykatë lidhur me stërgjatën e procedurave, ende nuk është marrë ndonjë vendim i instancës përfundimtare në Gjykatën Supreme.
25. Nga kjo del se, në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47.2 të Ligjit dhe rregullit 56(2) të Rregullores së punës, më 20 qershor 2011, njëzëri

VENDOS

- I. TA HEDHE kërkesën si të papranueshme.
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Ivan Čukalović



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani

